

Qendrat teknike e TCS me gjithë dëshirë janë në dispozicionin tuaj për të dhënë informacione.

Nr. tel. 0844 888 111
test.tcs.ch/ratgeber.tcs.ch

3.161.01-ALB
01.2025



Mënyra e duhur për të siguruar fëmijët në veturë

Gjuhë të tjera të arritshme nën:
kindersitze.tcs.ch

bfu
bpa
upi



Fonds für Verkehrssicherheit FVS
Fonds de sécurité routière FSR
Fondo di sicurezza stradale FSS



TCS – gjithmonë pranë meje.


Ulësja e përshtatshme për fëmijën mbron jetën e fëmijës suaj.

Video me këshilla dhe më shumë informacione nën:
kindersitze.tcs.ch



Çdo vit rreth 400 fëmijë aksidentohen në veturë!


Një nga dy fëmijë nuk është siguruar në mënyrë të duhur dhe një nga 14 fëmijë nuk është siguruar fare me rrip!



Grupi 0+ (0–13kg)



Grupi I (9–18kg)



Grupe II/III (15–36kg)

ECE R44 (norma e vjetër)

ECE R129/i-Size (norma aktuale: zgjedhja sipas shtatlartësisë në cm)

E detyrueshme: Ulëse fëmijësh me licencë ECE R129 duhet të montohen të paktën gjatë 15 muajve të parë të jetës së fëmijës me drejtim nga mbrapa.

E rëndësishme

Në vendet me rrip sigurimi me 3 pika lidhëse, për fëmijët **nën moshën 12 vjeçe, që janë më të shkurtër se 150 cm**, duhet të përdoret një instalim i përshtatshëm për mbajtjen e fëmijës (p.sh. ngritës i ulëses me ose pa mbështetëse kurrizi) (sipas nenit 3a të dispozitës për rregullat e komunikacionit rrugor).

Vini re **instruksionin e përdorimit** për ulësen e fëmijës si dhe për mjetin motorik. Rripi duhet të qëndrojë sa më i shtrënguar në trupin e fëmijës (Hiqni ose hapni xhakëtë e

dimrit, përndryshe efekti i mbrojtjes është i reduktuar).



Kalimi i gabuar i rripit, fëmija nuk është mbrojtur në mënyrë optimale

Gabime në përdorim (Misuse)

Një nga dy sisteme për sigurimin e fëmijëve në veturë (KRS) aplikohet në mënyrë të gabuar, një nga tre sisteme ka deficite të

mëdha. Kjo shfaqet në një ekzaminim për përdorime të gabuara i kryer nga BFU në bashkëpunim me TCS. Gabimi dukshëm më i shpeshtë ka të bëjë me rregullimin e rripit të sigurimit. Posaçërisht tek ngritja e një ulëse fëmijësh pa mbështetëse kurrizi, në shumicën e rasteve caktohet një rrugë e gabuar e rripit. Rripat, që kalojnë në nivelin e shpatullës gjithashtu rregullohen shpesh në mënyrë të gabuar ose rripat kalojnë në mënyrë të ndërthurur. Më shumë informacione nën kindersitze.tcs.ch


Foshnja

- Montoni maksikozën gjithmonë **me drejtim nga mbrapa**.
- Tek ulëset e fëmijëve me drejtim nga mbrapa në ulësen e pasagjerit me patjetër duhet të çaktivizohet airbegu ose të instalohet ulësja e fëmijës si alternativë në ulëset e pasme.
- Kaloni vetëm në grupin më të madh, kur koka e fëmijës ngrihet mbi maksikozën. **Në ulëse fëmijësh sipas normës së re ECE R129, fëmijët deri në moshën 15 muajsh duhet të sigurohen me drejtim nga mbrapa.**



Fëmijët e vegjël

- Sigurohuni, që ulësja e fëmijës të jetë lidhur fort me veturën. **Ruhuni nga montimi tepër i liruar!**
- Tek ulëset e fëmijëve me fiksime Isofix (lidhje e normuar me ngulitje): Kontrolloni lejen e përdorimit në bazë të listës së tipave të mjeteve motorike të ulëses së fëmijës.
- Kaloni vetëm në grupin më të madh, kur koka e fëmijës **ngrihet mbi maksikozën**.



Fëmijët

- Fëmijët deri në moshën 12 vjeçe ose deri në 150 cm shtatlartësi (ai kusht, që plotësohet i pari) kanë nevojë për **një ngritës të ulëses me mbështetëse kurrizi** për më shumë komfort dhe siguri. Vërtet një ngritës i thjeshtë i ulëses lejohet, por nuk ofron mbrojtje në një përplasje anash.
- Kujdesuni për një rrugë korrekte dhe **një shtrëngim të mirë të rripit**.
- Vendet më të sigurta në veturë edhe për fëmijët më të mëdhenj **janë vendet e pasme**.

